



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 182 Prot

Tiranë, më 07.12. 2010

VENDIM Nr.121, dt. 07.12.2010

- I. Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 07.12.2010, mbasi shqyrtoi "Detyrën e Projektimit për Studim Urbanistik në zonën "Kalaja e Turrës", Synej, Kavajë – të paraqitur nga Subjekti "FINSEC" sh.p.k,

VENDOSI:

- I. Të miratojë në parim Detyrën e Projektimit me kusht përfshirjen në të, të detyrimeve për trajtimin e monumenteve të kulturës dhe potencialit arkeologjik në zonën e marrë në studim.
- II. Subjekti "FINSEC" sh.p.k të planifikojë në buxhetin e këtij studimi edhe fondin përkatës për realizimin e vëzhgimit intensiv arkeologjik apo kryerjen e sondazheve arkeologjike nëse ato do të nevojiten.
- III. Para fillimit të zbatimit të punimeve të nënshkruhet kontrata dypalëshe midis "FINSEC" sh.p.k dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
FERDINAND XHAFERAJ  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
ROLAND OLLI

Konceptoi: M. Mcini  
Konfirmoi: S. Lela



AGJENCIA E  
SHERBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al